

VENDIM
Nr. 2, datë 3.1.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, neni 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhërin nr. 21, datë 6.2.2023, të Kryetarit të Autoritetit, “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhërin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhërin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 2, datë 3.1.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Shkresa me nr. 61 prot., datë 27.7.2023, relacion për legjitimimin e kësaj kërke në mbledhjen e Autoritetit.

2. Shkresa me nr. 63 prot., datë 27.7.2023, nga Drejtoria e Verifikimit të Figurave për drejtorin e arkivit, për identifikimin, mbledhjen dhe dorëzimin e dokumentacionit të plotë arkivor, për 17 kërkesat e legjitimuara në mbledhjen e datës 27.7.2023.

3. Shkresa me nr. 67 prot., datë 12.9.2023, relacion nga Drejtoria e Verifikimit të Figurave mbi mbylljen e procedurës në mbledhje.

4. Vendimi nr. 6, nr. prot. 68, datë 12.9.2023, i cili iu përcoll institucionit të Presidentit nëpërmjet shkresës nr. 92, datë 13.9.2023.

5. Shkresa me nr. 93 prot., datë 13.9.2023, shkresë përcjellëse dhe vendimi nr. 7, nr. 69 prot., datë 12.9.2023 drejtuar MEPJ-së.

6. Shkresa nr. prot. 96, datë 30.10.2023, drejtuar Institucionit të Presidentit nga Autoriteti.

- Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

- Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

- Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula